



Datë: 10.02.2026
Numër Protokolli: 744/2026

A.nr.48/2026

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtare me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.48/2026 të datës 15.01.2026, të parashtruar nga ankuesi E.G, kundër organit të punësimit: Komuna e Pejës në çështjen juridik ‘ *kontestim konkursi* ’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.48/2026 e datës 15.01.2026, e parashtruar nga ankuesi E.G.

A r s y e t i m

Ankuesi E.G (me tej referuar vetëm ankuese), më datë 15.01.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr. 48/2026, me pretendimet ankimore lidhur me konkursin RN00019073, të datës 03.12.2025, për Grup i Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën ‘ Zyrtar për Shërbim me Qytetar Profesional 2, të zhvilluar nga Komuna e Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 02.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Pejës, ndërsa kjo e fundit, më datë 28.01.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr.48/2026 të datës 13.01.2026 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Njoftimi i datës 15.01.2026 nr.01-112/01-0002724/26 të NJMBNJ në Komunën e Pejës për Verifikim paraprak; Përgjigjen e datës 28.01.2026 të Komunës së Pejës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Komuna e Pejës me datë 03.12.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00019073 për emrin e grupit “Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës “ Zyrtar për Shërbim me Qytetar” Profesional 2, numri i kërkuar (1) pozitë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 04.12.2025 deri me 02.01.2026, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi.

Ankuesi me datë 15.01.2026 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke kundërshtuar ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit, respektivisht pretendon se aplikacioni në fazën e verifikimit paraprak i është refuzuar pa bazë ligjore.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i’u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se:....12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative..* si dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: Ankesa në procedurë pranimit. 1. *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve dhe rrjedhimisht konstatoi se kandidati për pranim në Shërbim Civil, në rast të pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtruar me datë 15.01.2026 në ditën në të cilën është bërë njoftimi për refuzimin të aplikacionit dhe si rrjedhojë nga shkresat e lëndës konstatohet se procedura e rekrutimit sipas konkursit me referencë RN00019073 për pozitën “Zyrtar për Shërbim me Qytetar”, është në fazën e testimit me shkrim, andaj mbi bazën e kësaj rezulton së ankesa e ankuesit është e parakohshme, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendoi si në dispozitivin e këtij.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr 48/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, E.G;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në K-Pejës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së